



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Materiale Ndertimi ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Rërë 14211000-3

Rërë natyrore 14211100-4

Granula, çakëll, pluhur guri, gurë zalli, zhavorr, gurë të thyer dhe të grimtuar, përzierje guri, përzierje rërë-zhavorr dhe agregate të tjera 14212000-0

Gurë zalli dhe zhavorr 14212100-1

Zhavorr 14212120-7 Produkte të minierave, metaleve bazike dhe të lidhura me to

Agregate 14212200-2

Çakëll 14212310-6

Hekur 14711000-8

Gëlqere e hidratuar 24213000-0

Tela me gjemba 31211330-0

Tela 44311000-3

Rrjeta teli 44313100-8

Shufra, kallamë, tela dhe profile të përdorur në ndërtim 44330000-2

Profile 44334000-0

Elementë pusetash 44423700-8

Drynj dhe kyçës të ndryshëm 44521000-8

Kapakë 44618340-0

Bojra vaji 44812210-0

Gëlqere 44921200-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.938.013 (dy milion e nentëqind e tridhjetë e tete mijë e trembedhjetë) **lekë pa TVSH**

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Fier”Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar), nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet (2024-2025), të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2026 (kestet e maturuara)**, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit..**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit **nga data e zhvillimit të procedurës**, shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar brenda tri viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi** dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar) është përcaktuar që kontratat e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikaten e Cilësisë **ISO 9001:2015** ose (*ekuivalente/ e barazvlefshme me të*) lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Pranohen edhe standardet shqiptare **SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- ✓ ISO 9001-2015 është e nevojshme për garantimin e cilësisë së produkteve apo shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme.
- ✓ Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e mësipërme. Ky kriter është e lidhur ngushtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në përpjestim me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe duhet të jenë të lëshuara nga autoritetet kompetente në mënyrë që të garantojë realizimin në kohe, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombetare të objektit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikaten e Menaxhimit Mjedisor **ISO 14001-2015** ose **ekuivalente**, të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), që verteton se sistemi i menaxhimit të mjedisit të mallrave objekt prokurimi, (e perkthyer dhe e noterizuar në shqip) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, edhe OE, Pranohen dhe **standardet shqiptare SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- ✓ ISO 14001:2015 Çertifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit : e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues do të sjellë produkte të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombetare të cilësisë.

- ✓ Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e mësipërme. Ky kriter është e lidhur ngushtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë
- ✓ dhe në përpjestim me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe duhet të jenë të lëshuara nga autoritetet kompetente në mënyrë që të garantojë realizimin në kohe, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombetare të objektit të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik për zerin me nr. rendor 14 në preventiv (Furnizim Vendosije Asfalt) duhet të ketë një Akt marrëveshje me një subjekt të Prodhimit të Asfaltit/**pronesi,qira**, brenda territorit të Bashkisë Fier ku shtrinë aktivitetin Shoqëria Rajonale Ujësjetel Kanalizime Fier duke bërë furnizimin sipas kërkesave të AK brenda një afati 2 ditë nga momenti i paraqitjes së kërkesës nga AK.

Argumentimi: Ky kriter kërkohet për garantimin e realizimit në kohe dhe sipas specifikimeve teknike të zërit nr. 14 në preventiv. Duke qenë se asfalti është material që prodhohet në impiante të specializuara dhe duhet të transportohet dhe të vendoset brenda afateve teknologjike të përcaktuara, operatori ekonomik duhet të disponojë një marrëveshje bashkëpunimi me një subjekt prodhues asfalti që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Fier .

2.3.5 Operatorët ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- Katalog, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se i plotësojnë specifikimet për mallrat e përcaktuara në listën e autoritetit Kontraktor, e për këtë ata duhet të paraqesin mostrat për secilin mall të kërkuar, fotografi apo kataloge, si dhe dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronesi ose me qera materiale 1 (një) mjet transporti mallrash me kapacitet jo më pak se 1,5 (një) presje pese) Ton.

Për mjetin në pronesi duhet të paraqitet: a) dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit;b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit.

Për mjetin e marrë me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm), e) foto e automjetit . Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerës/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Per plotesimin e kriterit te mesiperme te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit). Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kërkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, ”d”, “dh”, “e”, “h”, ”i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Ne zbatim te ketyre ndryshimeve ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion nje mjet transporti me kapacitet mbajtes jo me pak se 1,5 ton, i nevojshem për kryerjen e transportit te mallrave objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te deklaroje se merr persiper magazinimin e perkohshem te materialeve te ndertimit si rere,çimento,gelqere dhe pllaka duke bere funizimin sipas kerkesave te AK brenda nje afati 2 ditor nga momenti i paraqitjes se kerkeses nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(indryshuar)

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion nje ambjent magazinimi i perkohshem per disa materiale ndertimi per te cilat Ndermarrja nuk ka siperfaqe per magazinim dhe do te meren nga operatori sipas nje grafiku dhe proces verbali ne menyre periodike mujore.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te dorezoje nje deklarate qe merr persiper transportin e mallrave drejt ambjenteve te SH.R.U.K Fier sipas kerkesave te ketij te fundit.

• Në fushën “SHËNIM” operatori ekonomik ofertues mund të shkruajë sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 ”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe i shërben AK në identifikimin sa më të saktë të informacionit teknik dhënë nga OE pjesëmarrës, duke sjellë lehtësi dhe shmangie konfuzioni në punën e Autoritetit Kontraktor për vlerësimin e ofertave. Kjo kërkesë lehtëson në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për të paraqitur produktin e saktë sipas kërkesave të DST, pasi në shumë katalogje teknike të produkteve të ndryshëm kemi konstatuar që pasqyrohen produkte me karakteristika dhe emërtime të ngjashme.

Nr	Pershkrimi i materialit	Specifikat dhe kerkesat teknike
1	Cimento	Cimentua duhet te jete e markes 32.5 R dhe ne perputhje me standardin S SH EN 197-1:2011 ose ekuivalent. Pranohe dhe standardet shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Rezistenca ne shtypje pas nje periudhe 4 javore duhet te jete te pakten 35MPa me tolerance +/-2MPa. Cimentua duhet te ngrije per te pakten 2 ore pas aplikimit dhe te kete nje koeficient zgjerimi jo me te madh se 1.3mm. Te paraqitet flete analiza e produktit,

		certifikata e perputhshmerise dhe fleta e sigurise se materialeve.
2	Hekur 12mm	Hekuri duhet te kete perberjen kimike ne %, si vijon: C jo me pak se 0.17, Mn te pakten 0.7, N \leq 0.01 dhe Cu $<$ 0.45 dhe ne perputhje me standardin EN10080 ose ekuivalent. Pranohen dhe standardet shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Forca e rezistences se keputjes te jete te pakten 545 MPa dhe zgjatueshmeria te pakten 10.2%. Te kete kaluar testimin sipas standardit EN 15630-1 ose ekuivalent. Te paraqitet flete analiza dhe katalogu i produktit Pranohen dhe standardet shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë
3	Zhavorr per beton	Zhavorri duhet te jete I lare dhe I fraksionuar.
4	Stabilizant	Kokrrizat e stabilizantit duhet te jene te lara dhe granulometria 5-15mm
5	Rere lumi	Rera duhet te jete e lare dhe e trajtuar dhe granulometria 0-3mm, si dhe te jete e shoqruar me flete-analize.
6	Pllaka	Pllakat e betonit duhet të jenë me përzierje çimento dhe rërë te lare me marke betoni jo me te ulet se 200, duhet të jenë të plota, pa hapesira boshe dhe pa plasaritje. Granulometria e agregatit te jete jo me shume se 10 mm, kurse trashesia e plakes 10 cm.
7	Tulla te kuqe	Tulla duhet te jete me permasat 60x120x250mm dhe ne perputhje me standarding EN771-1 ose ekuivalent. Pranohen dhe standardet shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Te kete perthithje te ujit (lageshtise) jo me te vogel se 13% dhe te rezistence jo me te vogel se 47.5 N/mm ² . Pesha e tulles te jete te pakten 1.88kg. Te paraqitet certifikata e cilesise dhe raport analiza per produktin e ofruar.
8	Bllloqe betoni	Bllloqet duhet te pergatiten me beton marka 200.

9	Boje antiruxho	Boja antiruxho duhet te jete e cilesise se larte dhe te kete si baze rreshire alkide. Duhet te kete densitet te pakten 1.27g/ml, hollesi nga 7-38 μ m. Koha e tharjes se bojës te mos jete me shume se 6.5ore.
10	Prajmer kartosere	Te jete primer bituminoz me baze solvent ose uji I pershtashtshem per pergatitjen esiperfaqeve para aplikimit te membranave bituminoze. Te siguroje ngjitje te larte ndermjet siperfaqes se betonit dhe membranës hidroizoluese Te kete aftesi te mire depertimi ne poret e betonit dhe te lidhe pluhurin siperfaqesore.
11	Gelqere e shuar	Gelqerja duhet te kete ne perberje te saj oksid kalciumi jo me pak se 70%, oksid magnezi te pakten 1% dhe granulim 90 μ m te pakten 7.5%
12	Cakell	Cakelli te kete granulim te 15-45mm
13	Boje hidromat	Boja hidromat duhet te jete e cilesise se larte dhe duhet te arrije tharjen e plote pas perdorimit ne me pak se 4ore. Duhet te kete densitet te pakten 1.58g/ml, hollesi nga 6-24 μ m. Mbetja e thate e bojës te jete me pak se 65% dhe rendimenti te jete te pakten 5m ² lysterje me nje liter boje.
14	F.V asfaltobeton	Asfaltobetoni duhet te jete i pergatitur me inerte te larta dhe te fraksionuara, si dhe me bitum, te shoqeruar me certifikate cilesie.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____ 2. _____ 3. _____